

# **RAPORTI VJETOR I VEPRIMTARISË SË KSHH PËR VITIN 2010**

## **1. Fjala përshëndetëse e Drejtores Ekzekutive znj. Vjollca Meçaj**

## **2. Vizioni dhe misioni i organizatës**

### *- Vizioni*

Organizatrat jofitimprurëse shqiptare, si aktore të rëndësishme të shoqërisë demokratike, kanë luajtur dhe luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e demokratizimit të vendit. Në mënyrë të veçantë ato sensibilizojnë shtetasit për të drejtat e sanksionuara në Kushtetutë dhe në aktet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë, monitorojnë veprimtarinë e administratës publike për të vlerësuar respektimin e të drejtave të njeriut prej saj, si dhe mbështetin dhe mbrojnë personat të cilëve u janë shkelur këto të drejta.

Ndërkohë që vendi ynë vazhdon të bëjë hapa përpara në drejtim të demoktatizimit të jetës së vendit dhe integritit europian, plotësimi i kërkesave të procedurës për liberalizimin e vizave me BE dhe prezantimi i kërkesës për të përfituar statusin e vendit kandidat për anëtarim, tregon një situatë politike që ofron garanci më të mëdha edhe në drejtim të zbatimit gjithnjë e më të mirë të të drejtave dhe lirive njerzore. Megjithatë nga subjekte të ndryshëm brenda vendit por dhe nga raportet e strukturave ndërkombëtare, që kanë monitoruar e vlerësuar sanksionimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut në vendin tonë, është konkluduar se krahas arritjeve ende ka shumë punë për të bërë në këtë drejtim.

Në këtë kuadër Komiteti Shqiptar i Helsinkit, si një nga organizatat më të vjetra në vend<sup>1</sup>, ka ofruar në vazhdimësi kontributin e vet të spikatur, në drejtim të sanksionimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kjo organizatë beson se OJF-të shqiptare dhe ajo vetë si një prej tyre, kanë kapacitetet e duhura dhe mund të luajnë rol të rëndësishëm në përmirësimin e standarteve të të drejtave dhe lirive në Shqipëri, si dhe për respektimin rigoroz të tyre. Ajo beson, gjithashtu se duke kombinuar metodat e punës dhe llojet e aktiviteteve, duke monitoruar zbatimin e detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me këto të drejta, duke ndihmuar për forcimin e shtetit ligjor dhe duke ju gjendur pranë individëve ose grupeve të individëve vulnerabël, mund të arrihen rezultate të shkëlqyera në këtë drejtim.

---

<sup>1</sup> KShH është themeluar më 16 Dhjetor 1990

KShH beson se shoqëria shqiptare, me punë e përkushtim, duke u qëndruar besnik parimeve të shtetit demokratik, mund të prosperojë dhe të garantojë për shtetsit e saj një jetë të lirë, dinjitoze dhe pa diskriminim, ku të drejtat e saknsionuara janë një realitet jetësor. Në këtë kontekst KShH ka përcaktuar si vizion të vet :

***Organizatat e shoqërisë civile mund dhe duhet të luajnë rol të rëndësishëm në përmirësimin e mjedisit për respektimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri si dhe në vetë respektimin e këtyre të drejtave***

Për rrjedhojë, KShH do të luajë edhe në të ardhmen, një rol aktiv në shoqërinë shqiptare dhe më gjerë, duke vepruar :

- **si promovues dhe mbrojtës e të drejtave të njeriut;**
- **si monitorues i zbatimit të detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me liritë dhe të drejtat e njeriut nga strukturat e Shtetit Shqiptar;**
- **si partner në dialogun me autoritetet shtetërore, me qëllim forcimin e efektshmërisë së respektimit të të drejtave të njeriut;**
- **si organizatë eksperte që ofron dije, pikëpamje të thelluara dhe ekspertizë lidhur me liritë e të drejtat e njeriut.**

#### **- Misioni**

Misioni i KShH-së është: ***të kontribuojmë për respektimin, gjithnjë e më të mirë, të të drejtave të njeriut dhe forcimin e shtetit ligjor, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me standardet e shoqërisë demokratike, aktet ndërkombëtare të zbatueshme në vendin tonë, si dhe legjislacionit në fuqi.***

Mandati i KShH-së është ***të llobojë e monitorojë, në mënyrë proaktive dhe reaguese, e së bashku me aktorë të tjerë të shoqërisë civile dhe organizata ndërkombëtare, të mbështesë përmbushjen e standardeve për të drejtat dhe liritë themelore; të sensibilizojë qytetarët shqiptarë dhe të gjithë aktorët përkatës për këto të drejta, duke ofruar trajnime dhe seminareve informuese, ndihmë ligjore falas për viktimat që u janë shkelur të drejtat; të rritë llogaridhënien e administratës publike, nëpërmjet denoncimit publik të fakteve që flasin për shkeljen e të drejtave të njeriut, konferencave të shtypit dhe deklaratave publike; të ndihmojë për zbatimin e ligjeve nëpërmjet kontributeve për rritjen e kapaciteteve të administratës publike, duke ofruar trajnime dhe seminareve formuese; si dhe të ofrojë oponencë ligjore dhe ekspertizë për reformat ligjore e institucionale, për përmirësimin e legjislacionit dhe zbatimin e tij në praktikë; të***

*përgatitë raporte, ose raporteve alternative, lidhur me zbatimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri e rajon. KShH i kushton shumë përpjekje forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve të brendshme institucionale dhe njerëzore.*

*- Vlerat e organizatës*

Në zbatim të misionit të vet, KShH u qëndron besnike parimeve dhe vlerave të mëposhtme:

- KShH-ja është një organizatë që përpiket të realizojë përbushjen e misionit të vet nëpërmjet programeve strategjike, të cilat përgatitin rrugën dhe mundësojnë realizimin e misionit dhe vizionit të organizatës.
- KShH është një prej organizatave me vlera të spikatura në respektimin e parimeve demokratike, si dhe qëndrimit të saj etik, parimor dhe të paanshëm politikisht për promovimin e të drejtave të njeriut, duke i vlerësuar çështjet nga këndvështimi i shoqërisë civile .
- KShH është një organizatë që beson në vlera të tilla, si: paanshmëria; objektiviteti; integriteti; përkushtimi; profesionalizmi gjithnjë në rritje; ambicia pozitive; pasioni për punën; transparenca për veprimtarinë që zhvillon, rezultatet e arritura dhe gjetjet gjatë monitorimeve që ndërmerr.
- Burimet njerëzore të KShH plotësohen nga një rrjet prej shtatë korrespondentësh proaktivë, me seli në qytete të ndryshme të vendit. Ky rrjet e furnizon organizatën me informacion, ekspertë dhe monitorues, të cilët raportojnë mbi një gamë të gjerë çështjesh dhe rastesh, në përputhje me objektivat e KShH-së.
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit mban lidhje të forta me organizata analoge, në vend e kudo në botë dhe bashkarisht llobojmë dhe promovojmë çështje të rëndësishme të të drejtave të njeriut.



### **3. Fokusimi në punë gjatë vitit 2010**

**( Përparësitë vjetore të përzgjedhura bazuar në strategjinë e organizatës 2008-2010)**

Me qëllim realizimin e objektivave të përcaktuara në misionin dhe vizionin e KShH-së, synimet strategjike për vitet 2010 kanë qenë:

1. Të kontribuojmë për zhvillimin e legjislacionit dhe reformave institucionale me qëllim sanksionimin dhe respektimin, gjithnjë e më mirë, të lirive dhe të drejtave të njeriut, në një shoqëri ku grupet e dobëta nuk diskriminohen.
2. Të kontribuojmë për përmirësimin e respektimit të të drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.
3. Të promovojmë ndihmën ligjore falas dhe rritjen e aksesit të shtetasve në sistemin e drejtësisë.
4. Të kontribuojmë për përmirësimin e trajtimit të personave me liri të kufizuar, në përputhje me të drejtat e sanksionuara dhe standartet të pranuar ndërkombëtare.
5. Të promovojmë respektimin e emigrantëve shqiptarë dhe personave të kthyer në Shqipëri.

6. Të zgjerojmë bashkëpunimin me OJQ të tjera aktive në fushën e të drejtave të njeriut, brenda e jashtë vendit, për të mbrojtur e respektuar më mirë të drejtat e njeriut në Shqipëri e kudo në botë.

#### **4. Problematika e trajtuar dhe rezultatet e punës së kryer gjatë vitit 2010**

Viti 2010 ishte viti i kremtimit të 20 vjetorit të themelimit të KShH. Ky jubile ishte një motiv më tepër për të shtuar rritmet e punës dhe për një angazhim më të madh të organizatës për plorësimin e detyrave. KShH morri përsipër dhe realizoi një sërë projektesh, që do të përmenden më poshtë, objekti i të cilave përkonte me objektivat e strategjisë së tij por, duke mbajtur parasysh edhe zhvillimet koherente në jetën politiko-ekonomiko-shoqërore të vendit, si dhe përparësitë e donatorëve me të cilët organizata ka bashkëpunuar.

Rezultatet e veprimtarisë së KShH për vitin 2010 janë të kënaqshme, detyrat e marra përsipër janë realizuar dhe shpenzimet financiare, për këtë qëllim, janë kryer në përputhje me kërkesat e projekteve të zbatuara, me legjislacionin në fuqi dhe kërkesat specifike të donatorëve.

Në këtë raport vjetor janë prezantuar çështjet që kanë përbërë objektin e punës sonë, problemet e evidentuara, zgjidhjet që janë ofruar, sukseset dhe përpjekjet tona për të përmirësuar situatën dhe rezultatet.

Gjatë veprimtarisë së vitit 2010 KShH realizoi arritje të reja në drejtim të promovimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave themelore të shtetasve, sidomos në drejtim të mbrojtjes nga diskriminimi, mbrojtjes së të drejtës për akses në organet e drejtësisë dhe të drejtës për një proces të rregullt ligjor, mbrojtjes së pronës dhe integritetit fizik e moral të personave. Veprimtaritë tona kanë ndikuar në përmirësimin e situatës së mbrojtjes dhe zbatimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, veçanërisht të personave me liri të kufizuar, personave që ndodhen në situata më të vështira. Gjithë veprimtarinë tonë e kemi zhvilluar në kuadër të një bashkëpunimi të ngushtë me organizata të shoqërisë civile dhe struktura të ndryshme publike, brenda e jashtë vendit, gjë që ka rritur impaktin e aksionit dhe reputacionin e KShH.

Për këtë qëllim janë përdorur metoda pune dhe mjete ndërhyrjeje si: monitorim proaktiv; studimi i situatës dhe raportimi për shkeljet e konstatuara; denoncim publik i tyre; lobim dhe advokaci për përmirësimin dhe respektimin, gjithnjë e më

të mire, të lirive dhe të drejtave të njeriut; trainime e kualifikime për struktura publike, që punojnë me persona me liri të kufizuar; trainim të stafeve të ojf-ve dhe të vetë stafit e bashkëpunëtorëve të KShH; oponencë dhe ekspertizë ligjore; veprimtari sensibilizimi; pjesmarrje në tryeza dialogu dhe rrjetëzim me subjektë të shoqërisë civile, bazuar në interesat e përbashkëta; adresimi i rasteve konkrete për shqyrtim në gjykata; etj.

Për zbatimin e projekteve të marra përsipër janë angazhuar seriozisht stafi i organizatës, korrespondentët tanë në rrethe, ekspertë e vëzhgues, të cilët bashkëpunojnë me KShH prej vitesh.

Organizata është kujdesur që edhe gjatë vitit 2010 të rritet vazhdimisht kualifikimi profesional i stafit, korrespondentëve dhe bashkëpunëtorëve, me qëllim përmbushjen gjithnjë e më mirë të detyrave që organizata merr përsipër, si dhe është bërë kujdes që të përmirësohen kushtet e punës për ta. Për këtë arsye punonjës të veçantë kanë marrë pjesë në trainime e seminare, brenda e jashtë vendit, ku kanë rritur kapacitetet e tyre në lidhje me planifikimin, buxhetimin dhe monitorimi i rezultateve të projekteve; rritjen e njohurive lidhur me fushën e të drejtave të njeriut; verifikimin e situatës dhe nxjerrjen e konkluzioneve në lidhje me zbatimin e politikave dhe strategjive të hartuara nga strukturat shtetërore, e të tjera.

Për realizimin e veprimtarisë gjatë vitit 2010 është shpenzuar një buxhet prej 206.647,12 euro, ose 28.676.421 lekë, të cilat janë kryesisht donacione të donatorëve të ndryshëm, që kanë pranuar të mbështetin zbatimin e projekteve tona. Në fund të këtij raporti do të gjeni një informacion rreth donacioneve të transferuara në favor të KShH, shpënzimet e kryera dhe vlerësimin e bërë mbas procesit të auditimit për këto shpenzime.

Në vijim informojmë, në mënyrë të përmbledhur, rreth projekteve dhe veprimtarive të zhvilluara nga KShH gjatë vitit 2010, duke i grupuar ato sipas synimeve strategjike të organizatës për këtë vit.

► **Objektivi strategjik i organizatës : *Të kontribuojmë për zhvillimin e legjislacionit dhe reformave institucionale me qëllim sanksionimin dhe respektimin, gjithnjë e më të mirë, të lirive dhe të drejtave të njeriut në një shoqëri ku grupet e dobëta nuk diskriminohen.***

◀ Projekte dhe veprimtari të zhvilluara për këtë qëllim :

**I.**  
**“RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT PUBLIK PËR LIGJIN E RI PËR  
MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI”**

**Qëllimi i projektit**

Përmirësimi i legjislacionit dhe i mekanizmave të tjerë për mbrojtjen nga diskriminimi.

**Objektivat kryesorë të këtij projekti**

1. Lobimi dhe advokimi me aktorët kryesorë përgjegjës për miratimin dhe zbatimin e ligjit të ri “Për mbrojtjen nga diskriminimi”;
2. Rritja e ndërgjegjësimit të strukturave publike dhe shtetsve për standartet e ligjin e ri dhe krijimi i bazës për zbatimin e tij të drejtë në praktikë.

**Veprimtaritë e realizuara:**

1. Rritja e ndërgjegjësimit për nevojën e hartimit dhe miratimin të ligjit ‘Për mbrojtjen nga diskriminimi’, ofrimi i ekspertizës së drejtpërdrejtë për hartimin e tij dhe pjesëmarrje aktive në koalicionin për mbrojtjen nga diskriminimi, së bashku me pjesëmarrës të tjerë të shoqërisë civile dhe organizma ndërkombëtarë.
2. Hartimi dhe publikimi i një fletëpalosjeje informuese në lidhje me ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi” me titull ‘*Të gjithë të barabartë përpara ligjit*’ si dhe të manualit ‘*Për mbrojtjen nga diskriminimi*’, në ndihmë të shtetasve.
3. Zhvillimi i 8 seminareve të hapura ndërgjegjësuese rreth ligjit ”Për mbrojtjen nga diskriminimi” me pjesëmarrjen e nxënësve dhe mësuesve të shkollave të mesme, si dhe studentë e pedagogë të fakulteteve juridike dhe të shkencave sociale në Tiranë, Vlorë, Shkodër dhe Korçë.
4. Realizimi i një konference rajonale “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, me objektivat rritjen e ndërgjegjësimit të autoriteteve shtetërore dhe e publikut të gjerë lidhur me situatën e diskriminimit në Shqipëri dhe më gjerë në rajon, si dhe gjetjen e rrugëve për përmirëfeksionimin e punës së strukturave përgjegjëse për zbatimin e ligjit dhe reduktimin e këtij fenomeni.

**Rezultatet e arritura në kuadër të këtij projekti janë:**

- Miratimi i ligjit nr. 10221, dt. 04.02.2010 ‘Për mbrojtjen nga diskriminimi’ si dhe vënia në efikasitet e Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- 756 nxënës, mësues, student dhe pedagogë u ndërgjegjësuam lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi dhe u njohën me tre materiale informuese mbi fenomenin e diskriminimit dhe standartet ligjore për mbrojtjen prej tij;
- U vendosën marrëdhënie bashkëpunimi midis KShH dhe Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe u ndërveprua me sukses në drejtim të hartimit të dokumentacionit të brendshëm të këtij institucioni.
- U ndërtua një rrjet bashkëveprimi midis institucioneve publike dhe organizatave jofitimprurëse për mbrojtjen nga diskriminimi.

Periudha e zbatimit: Janar 2010 - Qershor 2010  
 Financuar nga: Civil Rights Defenders  
 Shuma e financimit: **21000 Euro**

## II.

### “PËRMIRËSIMI I ZBATIMIT TË LIGJIT TË RI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI”

#### Qëllimi i projektit

Përmirësimi i situatës për mbrojtjen nga diskriminimi në Shqipëri.

#### Objektivat kryesorë të këtij projekti

1. Rritja e ndërgjegjësimit të grupeve të studentëve fakulteteve të shkencave sociale dhe juridike, si dhe nxënësve dhe mësuesve të shkollave të mesme lidhur me ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”;
2. Përmirësimi i mëtejshëm i funksionimit të Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimit.

#### Veprimtaritë e realizuara:

1. Lobimi dhe rritje e ndërgjegjësimit të aktorëve kryesorë përgjegjës për miratimin e akteve nënligjore mbështetëse të Institucionit të Komisionerit për mbrojtjen nga Diskriminimi.
2. Ripublikimi dhe shpërndarja e fletëpalosjes “*Të gjithë të barabartë përpara ligjit*” si dhe i manualit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”,



3. Zhvillimi i 6 seminareve ndërgjegjësuese, me nxënës dhe mësues të shkollave të mesme, si dhe studentë dhe pedagogë të fakulteteve juridike dhe të shkencave sociale në Fier, Korçë, Elbasan me tematikë rreth fenomenit të diskriminimit dhe standartet ligjore për mbrojtjen prej tij.

**Rezultatet e arritura :**

- Rritja e mëtejshme e ndërgjegjësimit të institucioneve publike dhe shoqërisë në përgjithësi për çështje që lidhen me diskriminimin;
- 300 nxënës, mësues, student dhe pedagogë të informuar për mbrojtjen nga diskriminimi;
- Ri-publikimi i fletëpalosjes informuese “*Të gjithë të barabartë përpara ligjit*” dhe e manualit “*Të kuptojmë dhe zbatojmë më mirë ligjin ‘Për mbrojtjen nga diskriminimi’*”, si dhe shpërndarja e tyre tek subjektet e interesuara.

**Periudha e zbatimit:** Tetor 2010 - Dhjetor 2010  
**Financuar nga:** Civil Rights Defenders  
**Shuma e financimit:** 22000 Euro

**III.**

**RRITJA E KAPACITETEVE TË OJF-VE PËR IDENTIFIKIMIN DHE PËRFAQËSIMIN E RASTEVE TË DISKRIMINIMIT**

**Qëllimi I projektit:**

Promovimi i respektimit të së drejtës për të mos u diskriminuar, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të organizatave që ofrojnë shërbime ligjore falas në këtë fushë.

**Objektivat Specifikë:**

1) Rritja e kapaciteteve profesionale të 4 OJF-ve dhe Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për identifikimin dhe përfaqësimin e çështjeve para strukturave përkatëse, gjyqësore dhe administrative, sipas ligjit.

2) Rritja e kapaciteteve të juristëve, përfaqësuesve të institucioneve publike dhe shoqërisë civile për të kuptuar dhe trajtuar rastet e shkeljes së të drejtës për të mos u diskriminuar.

### **Veprimtari të realizuara:**

- 1) U zhvillua trajnim trajnerësh me punonjës të 4 organizatave që ofrojnë shërbim ligjor falas në Tiranë, me tematikë “Identifikimi i rasteve të diskriminimit dhe përfaqësimi i tyre para organeve administrative dhe gjyqësore”.
- 2) U zhvilluan 4 trajnime në qytetet e Tiranës, Vlorës, Shkodrës dhe Korçës, me qëllim ngritjen e kapaciteteve të shoqërisë civile lidhur me kuadrin ligjor për mbrojtjen nga diskriminimi dhe shprehitë praktike për trajtimin e rasteve të diskriminimit.
- 3) U organizua një vizitë pune në Stockholm të Suedisë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të 4 organizatave që ofrojnë shërbim ligjor falas dhe Komisioneren për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me qëllim marrjen e eksperiencës positive në drejtim të mbrojtjes ligjore të viktimave të diskriminimit dhe organizimin e punës për këtë qëllim, Gjatë kësaj vizite pune, në zyrat e organizatës CRD në Stokholm, u organizua një takim informues me përfaqësues të shoqërisë civile Suedeze dhe u bashkëbisedua rreth temës “Situata e të drejtave të njeriut dhe shteti i së drejtës në Shqipëri”, ku drejtorja ekzekutive e KShH, prezantoi një panoramë e përgjithshme rreth situatës të të drejtave të njeriut në Shqipëri.

### **Rezultatet e arritura :**

- U rritën kapacitetet profesionale të 17 juristëve të ojf-ve dhe stafit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që punojnë për ofrimin e shërbimit ligjor falas, lidhur me çështje praktike dhe teorike të identifikimit dhe shqyrtimit të rasteve të diskriminimit.
- U rritën njohuritë e 77 përfaqësuesve të shoqërisë civile në Shkodër, Korçë, Vlorë dhe Tiranë lidhur me kuadrin ligjor të mosdiskriminimit dhe njohurive praktike lidhur me identifikimin e rasteve të diskriminimit.
- Shoqëria civile dhe media suedeze u ndërgjegjësu lidhur me situatën e të drejtave të njeriut në Shqipëri.

**Periudha e Zbatimit**

Tetor 2010 – Mars 2011

**Donatori:**

Civil Rights Defenders

**Buxheti:**

15,000 Eur

## IV.

### **PËRMIRËSIMI I SITUATËS SË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË SHQIPËRI PËRMES FUQIZIMIT TË SHTETIT LIGJOR(Klinika Ligjore IV)**

#### **Qëllimi kryesor i projektit**

Përmirësimi i mëtejshëm i funksionimit të shtetit të së drejtës dhe situatës së të drejtave të njeriut në Shqipëri.

#### **Objektivat kryesore:**

1. Realizimi i aktiviteteve lobuese dhe advokuese, si dhe ofrimi i ekspertizës ligjore për përmirësimin e legjislacionit që garanton respektimin më të mirë të të drejtave të njeriut.

#### **Rezultatet e arritura :**

- Ofrimi i vërejtjeve dhe sugjerimeve konkrete për përmirësimin e projektligjeve dhe akte nënligjore të ndryshme si Ligji “*Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore*”, “*Për faljen*”, “*Për Inspektimin financiar publik*”, “*Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës*”, “*Për sistemin arsimor parauniversitar në Shqipëri*”, si dhe aktet nënligjor “*Për rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve*” parashtruar për miratim në Këshillin e Ministrave, si dhe prezantimi i tyre në Qeveri dhe Komisionet Parlamentare përkatëse.

► **Objektivi strategjik i organizatës: *Të promovojmë ndihmën ligjore falas dhe rritjen e aksesit të shtetasve në sistemin e drejtësisë.***

◀ **Projekte të zbatuara për këtë qëllim :**

## I.

### **PËRMIRËSIMI I SITUATËS SË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË SHQIPËRI PËRMES FUQIZIMIT TË SHTETIT LIGJOR(Klinika Ligjore IV)**

#### **Qëllimi kryesor i projektit**

Përmirësimi i mëtejshëm i funksionimit të shtetit të së drejtës dhe situatës së të drejtave të njeriut në Shqipëri.

## **Objektivat e projektit:**

2. Identifikimi i nevojave në kuadër të reformës në sistemin gjyqësor dhe ushtrimi i presionit për përmirësimin e funksionimit të këtij sistemi, me qëllim përmirësimin e situatës së të drejtave të njeriut.
3. Rritja e aksesit të qytetarëve për përfitim të ndihmës ligjore falas dhe rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve shtetërore për respektimin e të drejtave të njeriut.

## **Veprimtari të realizuara:**

- Përgatitja dhe publikimi i planit strategjik të organizatës për periudhën 2011 – 2013.
- Trajnimi i 16 vëzhguesve të KShH lidhur me metodologjinë e monitorimit të procesit gjyqësor dhe monitorimi i 310 seancave gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Durrës, Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, me qëllim vëzhgimin e disa aspekteve të rregullshmërisë së proceseve gjyqësore.
- Zhvillimi i një tryezë e rrumbullakët për të diskutuar me palët e interesuara rreth gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve të përgatitura nga KShH pas monitorimeve të kryera në gjykatat e sipërshënuara.
- Zhvillimi i një konference për shtyp dhe reagimi public, nëpërmjet 6 deklaratave dhe njoftimeve për shtyp, lidhur me keqfunksionimin e sistemit të drejtësisë dhe nevojën për përmirësim në këtë drejtim.
- Informimi i shtetasve për të drejtat e tyre dhe shërbimet ligjore që ofron KSHH, nëpërmjet publikimit dhe shpërndarjes së 5000 kalendarëve të xhepit, prodhimit e shpërndarjes së spilave me logon e KSHH-së dhe materialeve të tjera propagandistike.
- Trajtimi i 410 ankesave të administruara nga shërbimi ligjor i KShH, për të cilat janë ofruar 191 këshillime ligjore, 378 ndërhyrje pranë institucioneve të ndryshme shtetërore, 248 raste verifikimi në vend të ankesave të adresuara. Trajtimi i një numri të konsiderueshëm ankesash nga rrjeti i korrespondentëve në rrethe.
- Zhvillimi i 27 misionesh sporadikë të monitorimit në institucionet e burgjeve dhe paraburgimit. Shkeljet e konstatuara, së bashku me rekomandimet e KShH për përmirësimin e gjendjes, u janë adresuar institucioneve përgjegjëse dhe organeve të tyre superiore.

- Reagimi, nëpërmjet 6 deklaratave për shtyp, në rastet e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut<sup>2</sup>
- Janë përfaqësuar 3 çështje gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese, me anë të të cilave është kërkuar shqyrtimi i kushtetueshmërisë së ligjeve “Për pastërinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës shtetërore dhe personave të zgjedhur”<sup>3</sup>, ligjit “Për parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar nëpërmjet masave parandaluese ndaj pronësisë”<sup>4</sup>, ligjit “Mbi disa ndryshime në ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronës”.
- Janë përfaqësuar ligjërisht disa çështje sensitive, në kuadër të zbatimit të standarteve të konventave të ratifikuara nga Republike e Shqipërisë, të vendimeve të Gjykatës së Strasburgut, ose në raste ku kërkohet ndryshimi i praktikave gjyqësore të krijuara në kundërshtim me ligjin si : rasti i të miturit me iniciale E.H për të kërkuar respektimin e të drejtave të tij si viktimë e aspektit civil të rrëmbimit ndërkombëtar të të miturit dhe kthimin e tij pranë nënës në Mbretërinë së Bashkuar; çështja Lika & Laska me qëllim vënien në zbatim të vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; çështja gjyqësore e qytetares V.R, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasanit, lidhur me kundërshtimin e pushimit të padrejtë të çështjes penale në të cilën ajo ishte e dëmtuar; çështja e shtetasit me iniciale L.L për revokimin dhe ndryshimin e masës mjekësore së dhënë nga gjykata “Mjekim i Detyruar” dhe për kompensim për burgimin e padrejtë të tij.
- Asistimi i Firmës Avokatore Angleze në mbrojtjen e shtetasit shqiptar me iniciale F.K për të kundërshtuar kërkesën për ekstradimin e tij në Shqipëri.
- Realizimi i monitorimit, në 8 bashki të vendit (Tiranë, Shkodër, Kukës, Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastrë dhe Korçë), me objekt vlerësimi i aksesit të shtetasve në organet e qeverisjes vendore (e drejta e informimit, liria e shprehjes, pjesëmarrja në mbledhjet e këshillit bashkiak, trajtimi i ankesave të qytetarëve, etj). Në përfundim të monitorimit, konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse iu bënë prezent organeve të pushtetit vendor dhe u pasqyruan në një raport të KShH-së.
- Monitorimi i institucioneve të shëndetit mendor, në qytetet e Vlorë, Elbasan, Shkodër, Tiranë, Korçë, Berat, Gjirokastrë dhe Kukës, për të vlerësuar gjendjen e respektimit të të drejtave të pacientit dhe kushteve të përgjithshme në këto institucione. Në përfundim të monitorimit,

<sup>2</sup> Për këtë referoju listës së deklaratave të përgatitura nga KSHH gjatë 2010 që i bashkëngjitet këtij raport.

<sup>3</sup> Gjykata Kushtetuese, nëpërmjet vendimit nr.9 (Mars 2010) pranoi kërkesën e KShH-së për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të këtij ligji

<sup>4</sup> Nëpërmjet vendimit nr.4 (Shkurt 2011), Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën e KShH për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut të këtij ligji.

konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse iu bënë prezent përfaqësuesve të institucioneve të monitoruara dhe u pasqyruan në një raport të KShH-së.

- Ndërmarrja e nismave të përbashkëta me aktorë të shoqërisë civile si adresimi i një letre të hapur Kryeministrit, Ministrisë së Jashtme dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për të votuar pro përfshirjes së personave LGBT në rezolutën e ekzekutimit ekstrajgjyqësor.
- Realizimi i 6 aktiviteteve sensibilizuese<sup>5</sup> me rastin 60 vjetorit të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Femijëve, Ditës Ndërkombëtare në mbështetje të viktimave të Torturës
- Realizimi i 5 forumeve në bashkëpunim me Akademinë e Filmit dhe Multimedias “Marubi” me rastin e Festivalit Vjetor të Filmit për të Drejtat e Njeriut. Forumet u realizuan në disa shkolla të mesme dhe burgun nr.313.
- Kremtimi i 20 vjetorit të KSHH-së dhe nderimi, në këtë kuadër, i aktivistëve të të drejtave të njeriut me tituj.

### ***Rezultatet e Projektit:***

1. Media dhe opinioni publik vendas dhe ai ndërkombëtar është sensibilizuar rreth rasteve konkrete të shkeljes së të drejtave të njeriut, nëpërmjet 14 deklaratave dhe njoftimeve për shtyp, lidhur me situatën e të drejtave të njeriut në Shqipëri, shkeljet konkrete në këtë drejtim.
2. Është rritur trasparenca e veprimtarisë së gjykatave dhe është përmirësuar shqyrtimi i çështjeve të parashtruara nga shtetasit nëpërmjet :
  - Monitorimit të veprimtarisë së tyre ( 310 seanca gjyqësore në gjykatat e Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Durrës, Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese)
  - Bërjes publike të konkluzioneve të monitorimit të veprimtarisë së gjykatave dhe çështjeve që lidhen me keqfunksionimin e tyre, të rezultuara nga monitorimi.
  - Rritjes së presionit ndaj autoriteteve shtetërore kompetente lidhur me problematikën e konstatuar në sistemin gjyqësor.
3. Është përmirësuar situata e të drejtave dhe lirive themelore të shtetsve nëpërmjet:
  - Rritjes së aksesit të shtetasve në shërbimet ligjore që ofron KShH ;
  - ndërgjegjësimin më të mirë të autoriteteve publike lidhur me standartet

---

<sup>5</sup> Seminare sensibilizuese me nxënës dhe studentë në disa qytete të vendit si Tiranë, Elbasan, Vlorë, Korçë dhe shfaqja e një filmi sensibilizues në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të miturit në Kavajë

demokratike dhe problematikën në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut;

- Shtimit të rasteve të përfaqësuara në gjykatat e të gjitha niveleve, vendase dhe ndërkombëtare dhe e rasteve të trajtimit të ankesave për shkelje të të drejtave nga administrata publike;
- Çështjeve të parashtruara në Gjykatën Kushtetuese, për të kërkuar shqyrtimin e kushtetueshmërisë së ligjeve që lidhen me të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve.
- Rritjes së kapaciteteve dhe të ekspertizës ligjore të ofruar nga shërbimi ligjor i KShH në përfaqësimet ligjore para gjykatave të brendshme dhe ndërkombëtare;
- Përmirësimit të kuadrit ligjor edhe nëpërmjet ekspertizës ligjore të ofruar nga KShH, për t'u përshtatur me standartet bazë kushtetuese dhe ato ndërkombëtare;
- Rritjes së veprimtarisë ëotch dog dhe advokues të KShH-së, veçanërisht në fushën penitenciare, veprimtarinë e qeverisjes vendore dhe trajtimit të shëndetit mendor.
- Rritjes së sensibilizimit të qytetarëve të ndryshëm, veçanërisht nxënësve dhe studentëve, për çështje të ndryshme të të drejtave të njeriut nëpërmjet forumeve, shpërndarjes së materialeve informuese etj,
- Shtimit të rasteve të ndërhyrjes pranë institucionet shtetërore për rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura të shtetasve;
- 27 misioneve sporadike të monitorimit në institucionet e burgjeve dhe paraburgimit dhe reagimit direkt për shkelje të konstatuara të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore,
- Monitorimit të institucioneve të shëndetit mendor, në qytetet e Vlorë, Elbasan, Shkodër, Tiranë, Korçë, Berat, Gjirokastrë dhe Kukës dhe adresimit tek organet përgjegjëse të shkeljeve të të drejtave të pacientëve të konstatuara.
- Zhvillimit të aktiviteteve sensibilizuese me rastin e 60 vjetorit të KEDNJ.
- Realizimit të 5 forumeve për diskutimin rreth të drejtave të njeriut në kuadër të Festivalit të Filmit për Të drejtat e Njeriut.

4. Është përmirësuar aksesimi i shtetasve pranë pushtetit vendor nëpërmjet :

- Monitorimit, në 8 bashki të vendit (Tiranë, Shkodër, Kukës, Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastrë dhe Korçë), me objekt vlerësimi i aksesit të shtetasve në organet e qeverisjes.

5. Janë përmirësuar aftësisht organizative dhe funksionale të KShH dhe marrëdhëniet me publikun nëpërmjet:

- Miratimit të strategjisë së rrethit të 2010-2013
- Rritjes së kapaciteteve të stafit, korrespondentëve dhe vëzhguesve, veçanërisht në drejtim të kuptimit të të drejtës për mosdiskriminim, monitorimit të sistemit gjyqësor; shkrimit dhe menaxhimit të projekteve
- Krenimit të 20 vjetorit të themelimit të KShH.

**Periudha e zbatimit:** Mars 2010 – Shkurt 2011  
**Financuar nga :** Civil Rights Defenders  
**Buxheti total:** 69 400 Eur

## II.

### **RRITJA E MUNDËSIVE PËR ZBATIMIN E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË SHQIPËRI.**

#### **Qëllimi i projektit:**

Përmirësimi i hapësirave ligjore lidhur me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe shfrytëzimi i tyre me efikasitet për plotësimin e të drejtave të shtetasve. (*Zbatimi i projektit vazhdon edhe gjatë vitit 2011*)

#### **Objektivat e projektit:**

1. Ekzekutimi, nga shteti shqiptar, i vendimit të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në favor të shtetasve A.Lika dhe V.Laska lidhur me pagimin e shpërblimit të vendosur nga kjo e fundit.
2. Inicimin e kërkesës për rishikimin e çështjes gjyqësore penale në ngarkim të dy shtetasve të sipërcituar.
3. Kontribuimi për përmirësimin e bazës ligjore dhe praktikave që mundësojnë zbatimin e menjëhershëm të vendimeve të formës së prerë të GjEDNj si dhe përmirësimin e dispozitave ligjore ekzistuese me qëllim rishqyrtimin e çështjeve, përfshirë dhe rihapjen e hetimeve, në rast të konstatimit të shkeljeve serioze për gjykim të drejtë.
4. Fuqizimi i aksionit të OJF-ve për realizimin praktik të të drejtave të sanksionuara me ligj.

#### **Veprimtari të realizuara:**



- Përgatitja e dosjes për në Gjykatën e Lartë dhe depozitimi i kërkesa për rishikim në Gjykatën e Lartë për V.L dhe A.L në datën 19 Nëntor 2010.
- Përfaqësimi ligjor i V.L në Gjykatën e Apelit për aplikimin e dënimit Alternativ dhe rekursin në Gjykatën e Lartë
- Monitorimi i ekzekutimit të vendimit të GJEDNJ-së, për këta shtetas, lidhur me dëmshpërblimin e caktuar në këtë vendim,
- Studimi i mundësisë së ndryshimit të legjislacionit vendas për të sanksionuar zbatimin e menjëhershëm të vendimeve të GjEDNj ose rishqyrtimin e çështjeve, duke përfshirë dhe rihapjen e hetimeve kur konstatohen shkelje të rënda të procesit të rregullt ligjor, si edhe gjetja e praktikave më të mira nga rajoni për këtë qëllim,
- Kryerja e fazës përgatitore për përgatitjen e draftligjit për ekzekutimin e menjëherëshëm të vendimeve të GJEDNJ-së për vendimet penale. Të dy këto draftligje do të shoqërohen me një relacion i cili do të përmbajë përmbledhjen e një “praktike më të mirë”, që do të identifikohet nga ekspertët lidhur me ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së.

#### **Rezultatet e projektit:**

1. Realizimi i dëmshpërblimit ne favor të A.L e V. L me fonde të shtetit shqiptar, të shumës së përcaktuar në vendimin e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut
2. Depozitimi i kërkesës për rishikim në Gjykatën e Lartë në kuadër të zbatimit të vendimit të GjEDNJ-së për rihapjen ose rigjykimin e çështjes dhe ofrimi i ndihmës ligjore falas për shtetasit A.L e V.L, në kuadër të realizimit të të drejtave të tyre,

**Periudha e zbatimit:** 1 Nentor 2010 – Qershor 2011  
**Financuar nga :** Fondacioni Soros dhe Civil Rights Defenders  
**Buxheti total:** 14170 USD (9900 USD nga Soros dhe 4270 USD nga CRD)

► **Objektivi strategjik i organizatës:** *Të kontribuojmë për përmirësimin e trajtimit të personave me liri të kufizuar, në përputhje me të drejtat e sanksionuara dhe standartet të pranuar ndërkombëtare.*

## ◀ Projekte të zbatuara për këtë qëllim :

### I.

## **“SË BASHKU PËR NJË RESPEKTIM MË TË MIRË TË TË DREJTAVE TË PERSONAVE TË PRIVUAR NGA LIRIA”**

### **Qëllimi i projektit**

Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të personave të privuar nga liria në përgjithësi dhe të grupeve në nevojë në veçanti, si dhe garantimi i trajtimit të tyre me dinjitet dhe njerëzi nga strukturat e policisë së shtetit dhe personeli i institucioneve të paraburgimeve/burgjeve.

### **Objektivat e projektit:**

1. Të përmirësojë llogaridhënien dhe zbatimin e ligjit nga ana e administratës publike, të komisariateve të policisë, të institucioneve të paraburgimeve/burgjeve, për një respektim dhe trajtim më të mirë të personave në kujdesin e këtyre institucioneve;
2. Të rrisë ndërgjegjësimin dhe njohjen e të drejtave të njeriut dhe zbatimin korrekt të ligjit nga punonjësit e policisë në komisaritet e policisë dhe institucionet penale;
3. Të japë ndihmesë psikologëve dhe punonjësve të kujdesit social për bërë të mundur ofrimin e një trajtimi të veçantë për personat e privuar nga liria, me fokus të veçantë në grupet në nevojë në institucionet penale.

### **Veprimtari të zbatuara**

1. Misione monitorimi të planifikuara dhe sporadike në disa institucione paraburgimi dhe burgje;
2. Hartimi dhe publikimi i raportit përfundimtar të vëzhgimeve të kryera;
3. Trajnimi i 147 drejtuesve të nivelit të mesëm të drejtimit për krijimin e një klime të sigurt për personat e privuar nga liria në institucionet penale në Tepelenë, Burrel, Lezhë dhe Tropojë;
4. Aftësimi i psikologëve dhe punonjësve të kujdesit social për të ofruar trajtim të diferencuar për personat e privuar nga liria me probleme mendore ose varësi nga drogat;

5. 25 trajnerë të institucioneve penale, të trajnuar për trajtimin e personave me probleme të shëndetit mendor në institucionet penitenciare;
6. Përpunimi i ekspertizës që do t'u përfrohet personelit që punon në sektorët e kujdesit të veçantë me personat me çrregullime mendore;
7. Mision vlerësimi mbi situatën në sektorët e kujdesit të veçantë të hapura në disa burgje pilot;
8. Sesione pune për përmirësimin e programeve të para lirimit për të dënuarit në institucionet penale Vlorë, Lezhë, Korçë.

## **Rezultatet e projektit**

- Përzullimi i hyrjes në fuqi të disa amendimeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të dt 25 Mars 2010 për shkak se cënonin të drejtat dhe trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve.
- Ministria e Drejtësisë dhe Autoritetet e institucioneve penale më të ndërgjegjësuar në lidhje me respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria, veçanërisht për të drejtat dhe trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin dhe të dënuarve me probleme të shëndetit mendor dhe ato me varësi nga drogat.
- Më shumë sesa 40% e komisariteve të policisë dhe institucionet penitenciare u monitoruan dhe gjetjet u përfshinë në një raport, i cili u publikua dhe iu dërgua autoriteteve shtetërore përgjegjëse të cilat në shumë raste reflektuan për problemet e ngritura.
- Punonjës policie të komisariteve të Qarkut Tiranë dhe Durrës më të trajnuar për zbatimin e efektshëm të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare në punën e tyre, si dhe me njohuri më të gjera lidhur me praktikën më të mirë nga disa vende evropiane lidhur me trajtimin e grupeve në pozita të dobëta,
- U prodhuan dhe u vunë në dispozicion të institucioneve përkatëse tre dokumente strategjike, respektivisht për trajtimin e personave të varur nga droga, për sektorët e kujdesit të veçantë për personat me çrregullime mendore dhe për sëmundjet ngjitëse.
- Në katër institucione pilot u hapën sektorë të kujdesit të veçantë për personat me problemet të shëndetit mendor dhe për ata me varësi nga drogat.
- U hartuan dhe u vunë në dispozicion të institucioneve përkatëse katër dokumente bazë në lidhje me profilet e personelit, programin ditor, protokollet e ndryshme dhe sistemi i raportimit në institucionet ku u hapën sektorët e kujdesit të veçantë për personat me probleme mendore.

**Periudha e zbatimit:** Janar 2009 - Tetor 2010

**Financuar nga :** Komisioni Evropian  
**Shuma e financimit:** 79.926.40 Euro (donacion)  
**Buxheti total :** 124.652 Euro

## II.

### **“NGRITJA E KAPACITETEVE PROFESIONALE TË INSTITUCIONIT TË RI-INTEGRIMIT NË KAVAJË”**

#### **Qëllimi i projektit**

Qëllimi i këtij projekti është të ofrojë një qasje dhe një filozofi të re në trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin, për të garantuar që të respektohet dinjiteti njerëzor dhe siguria personale e tyre, si dhe t'i përgatisë ata për riintegrim në shoqëri pas lirit.

#### **Objektivi i projektit**

Objektivi kryesor i këtij projekti është ofrimi i metodave bashkëkohore në punën e personelit me të miturit në institucionin e veçantë për të miturit në Kavajë.

#### **Veprimtaritë të zhvilluara**

1. Një mision pune me grupin drejtues të nivelit të lartë dhe të mesëm të institucionit të Kavajës për identifikimin e nevojave të personelit për aftësimin e tyre në punën me të miturit.

#### **Rezultate konkrete**

1. Janë identifikuar nevojat të personelit të Institutit të të miturve në Kavajë, për aftësimin e tyre profesional në punën me të miturit dhe është ndërtuar programi përkatës i punës , në bashkëpunim me institucionin dhe DPB. *( zbatimi i projektit vazhdon edhe gjatë vitit 2011)*

**Periudha e zbatimit:** Korrik 2010 - Dhjetor 2010  
**Financuar nga:** UNICEF Albania  
**Shuma e financimit:** 1.491.188 Lekë  
**Buxheti Total:** 1.861.088 Lekë

### III.

## “PËR NJË PERSONEL TË BURGJEVE SA MË PROFESIONAL DHE NJË DREJTIM CIVIL TË SISTEMIT SHQIPTAR TË BURGJEVE”

### Qëllimi i projektit

Të përmirësojë trajtimin e personave të privuar nga liria në përputhje me standartet e të drejtave të njeriut.

### Veprimtari të realizuara

- Takime konsultative lidhur me hartimin e strukturës së programit mësimor për trajnimin e drejtuesve të mesëm në burgje;
- Miratimi i programit mësimor dhe futja e saj në sistemin e qendrueshëm të trajnimeve të personelit të nivelit të mesëm drejtues në burgje;
- Hartimi i manualit të trajnimit për nivelin e mesëm të drejtuesve në sistemin e burgjeve shqiptare.

### Rezultatet kryesore të projektit:

- Prezantimi i një praktike të mirë për trajnime të specializuara dhe vazhduese të drejtuesve të nivelit të mesëm drejtues në institucionet penitenciare shqiptare;
- Një program i plotë trajnimi me fokus drejtuesit e nivelit të mesëm është i gatshëm për t’u përdorur në trajnimet e mëtejshme të drejtuesve të nivelit të mesëm në burgje.
- Miratimi i kurrikulës mësimore për drejtuesit e nivelit të mesëm nga drejtuesit e lartë të sistemit të burgjeve. *(Projekti është në zbatim e sipër edhe gjatë 2011)*

<b>Periudha e zbatimit:</b>	Korrik 2010 - Korrik 2011
<b>Financuar nga:</b>	Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shqipëri
<b>Shuma e financimit:</b>	58.365 Euro
<b>Buxheti Total:</b>	79.565 Euro

► Objektivi strategjik i organizatës: *Të zgjerojmë bashkëpunimin me OJQ të tjera aktive në fushën e të drejtave të njeriut, brenda e jashtë vendit, për të mbrojtur e respektuar më mirë të drejtat e njeriut në Shqipëri e kudo në botë.*

◀ Veprimtari të zhvilluara për këtë qëllim :

KShH, ashtu si edhe më parë, e ka zhvilluar një pjesë të veprimtarisë së vet në bashkëpunim me organizata të tjera jofitimprurëse, ose institucione publike, me të cilat na bashkon misioni ose interesi i përbashkët. Gjatë vitit 2010 ka vazhduar, në nivele të kënaqshme, bashkëpunimi me Avokatin e Popullit, veçanërisht në veprimtari që lidhen me monitorimin e të drejtave të personave me liri të kufizuar, si dhe bashkëpunimi me Koalicionin për të Drejtat e Paaftësisë, bashkëpunimi me organizata të tjera, që kanë në fokus të drejtat e njeriut, si QNLQ, TILAS, CRCA etj, me të cilat janë shkëmbyer eksperiencat dhe është marrë pjesë, reciprokisht, në veprimtaritë e zhvilluara gjatë kësaj periudhe. Përmendim këtu bashkëpunimin midis OJF-ve të Tiranës dhe Shkodrës, në kuadër të përmbytjeve në qytetin e Shkodrës në Janar 2010, për të ndihmuar qytetarët e përmbytur, ndjekjen e rastit të diskriminimit të K.C, për shkak të orientimit seksual të ndryshëm. KShH pati rolin e organizatës inisiatore për këtë qëllim. Gjithashtu ka vazhduar me sukses bashkëpunimi për zhvillimin e Festivalit të Filmit për të Drejtat e Njeriut, ku përveç ofrimit të një kontributi për financimin e eventit, KShH është edhe pjesë e Bordit Vendimarrës së festivalit, së bashku me struktura të tjera ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile shqiptare.

Në kuadër bashkëpunimit ndërkombëtar mund të përmendim edhe lobimin e ojf-ve, nga vende të ndryshme të botës, për mbështetjen e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, kryer në muajin Shkurt të 2010

Ne arenën ndërkombëtare Komiteti ka forcuar bashkëpunimin me organizatën CRD ( ish Komiteti Suedez i Helsinkit), me Komitetin Grek të Helsinkit dhe Komitetin Maqedonas të Helsinit me të cilët ka këmbyer përvojën dhe dokumentacionin sensibilizues të krijuar. Mbetet detyrë zgjerimi i mëtejshëm i bashkëpunimit me organizata brenda e jashtë vendit.

- **Inisiativa ligjbërëse në bashkëpunim.**

Studimi dhe përpilimi i vërejtjeve dhe sugjerimeve në lidhje me projektligjin “*Për Inspektimin financiar publik*”, është kryer në kuadër të bashkëpunimit të të gjitha organizatave jofitimprurëse, me seli në Tiranë, të cilat u angazhuan për këtë qëllim me nismë të SOROS Fontation dhe TACSO.

**- Bashkëpunimi me median e shkruar dhe vizuale.**

KShH edhe gjatë vitit 2010 ka vazhduar të rritë e të konsolidojë raportet e saj me median e shkruar dhe atë elektronike. Duke i konsideruar ata si partnerë të fuqishëm në drejtim të informimit të publikut, lidhur me të drejtat e njeriut, si dhe sanksionimin dhe zbatimin e tyre. Mediave u janë përcjellë vazhdimisht deklaratat, letrat e hapura dhe informacione të tjera që KShH ka prodhuar.

Përfaqësues të KShH-së kanë qenë shpesh të ftuar nga mediat televizive, ose janë intervistuar prej tyre, për të trajtuar çështje që lidhen me të drejtat e njeriut, si dhe kanë botuar shkrime të përgatitura nga stafi i KShH për çështje me interes për publikun. Gjatë vitit 2010 KShH, deklaratat dhe njoftimet për shtyp të KShH-së janë pasqyruar gjatë edicioneve të lajmeve të dhëna në televizione në 9 raste dhe janë publikuar nëpërmjet artikujve të shkruar në gazeta në 35 raste.

**- Bashkëpunim me struktura publike dhe ndërkombëtare për hartimin e raporteve dhe vlerësimin e situatës së të drejtave të njeriut në vend.**

Edhe gjatë vitit 2010 KShH ka qenë një nga ofr-të, mendimi i të cilës është kërkuar në kuadër të hartimit të raporteve, që vendi ynë përgatit në kuadër të angazhimeve nëpërmjet akteve nderkombëtare të ratifikuara, e që lidhen me të drejtat e njeriut. Vlen të përmendet në këtë drejtim bashkëpunimi i KShH me Ministrinë e Punëve të Jashtme

Përfaqësues të KShH kanë zhvilluar takime të shumta dhe kanë ndarë mendimet me delegacione të BE, KE, deputetë e funksionarë të vendeve të ndryshëm, që vijnë për vizitë në Shqipëri dhe dëshërojnë të njihen me situatën e të drejtave të njeriut, të prezantuar nga subjekte të pavarur politikisht. Të tilla përmendim takime me eurodeputetë, delegacionin e deputeteve kanadeze, delegacionin e KE etj.

## **5. Zhvillimi institucional i organizatës**

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimarrës i organizatës, sipas statutit, ndërsa Bordi është një organ këshillimor. Këto organe kanë funksionuar rregullisht gjatë vitit 2010 dhe me vendimarrjen e tyre kanë orientuar gjithë veprimtarinë e organizatës, në përputhje me misionin e vet.

#### **- Jeta organizative**

Gjatë vitit 2010 Asambleja e Përgjithshme është mbledhur 4 herë për të diskutuar lidhur me çështje të ndryshme organizative të KShH-së si dhe lidhur me ngjarje të rëndësishme të situatës së të drejtave dhe lirive themelore në vend. Gjatë 2010-ës, Asambleja e KShH-së ka marrë vendimin nr.1, datë 21.01.2010, lidhur me domosdoshmërinë e ushtrimit të kërkesës pranë Gjykatës Kushtetuese, me objekt antikushtetueshmerinë e ligjit *"Për parandalimin dhe goditjen e krimit të oerorganizuar, trafikimit dhe korrupsionit, nepermjet masave parandaluese kundër pasurisë"*, vendimin nr. 2 *"Për miratimin e raportit vjetor të veprimtarisë së KShH më 2009"*.

Bordi Këshillimor dhe në veçanti kryetarja e tij znj. Aurela Anastasi, është informuar në vazhdimësi nga Drejtorja Ekzekutive për zhvillimet në organizatë dhe prej këtij organi është marrë këshillë për trajtimin e çështjeve të ndryshme ligjore dhe organizative, që kanë lindur gjatë veprimtarisë.

#### **- Forcimi i rrjetit të korrespondentëve**

Korespondentët janë struktura të KShH, që veprojnë jo me kohë të plotë, megjithatë roli i tyre është shumë i rëndësishëm. Ata i sjellin organizatës informacione lidhur me situatën e të drejtave të njeriut në rrethet e tyre ose për çështje të tjera që lidhen me misionin e KShH. Kapacitetet e tyre, të fuqizuara vit pas viti, i japin mundësi organizatës të verifikojë, të monitorojë dhe të nderhyjë, në kohë rekord, për ngjarje e situata të shkeljes së të drejtave të njeriut kudo në Shqipëri. Korresponndentët janë, gjithashtu edhe një pikë mbështetëse në rastet e zhvillimit të veprimtarive në zonën ku ata veprojnë. Ata kanë bashkëpunuar edhe për projekte monitorimi e vëzhgimi të situatave, që kanë qenë objekt i projekteve që ka zbatuar organizata gjatë këtij viti.

Rrjeti i korrespondentëve (7 persona në qytetet Shkodër, Kukës, Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastër, Korçë) dhe i vëzhguesve është instruktuar e kualifikuar në vazhdimësi, si për çështje konkrete, për të cilat janë thirrur të veprojnë, ashtu dhe për çështje bazike të të drejtave të njeriut. Gjatë vitit 2010 iu kushtua rëndësi e veçantë dhe shtimit të numrit të vëzhguesve dhe bashkëpunëtorëve, të specializuar,



duke i përzgjedhur ata nga fusha e shëndetësisë, drejtësisë dhe psikologjisë. Sistemi i kontraktimit të tyre, për nevoja të projekteve, është përmirësuar dhe është shoqëruar gjithmonë me terma reference të qarta.

## 6. Burimet financiare dhe korrektësia e shpenzimit të fondeve të akorduara nga donatorët

Për mbajtjen e kontabilitetit të Organizatës përdoret kontabiliteti i programuar “ALPHA platinum” versioni për OJF-të. Ky program përdor sistemin e mbajtjes të llogarive “me parti dyfishe” dhe lejon raportimin në Projekte me monedhat sipas donacioneve, buxheteve e llogarive monetare (Euro USD, lekë) si dhe të treguesve të Bilancit të gjithë Organizatës në një monedhë të vetme, në lekë.

Po paraqesim më poshte pasqyrën “Te ardhura e Shpenzime” në dt. 31.12.2010. Të gjitha shpenzimet e KShH-së janë shpenzime në kuadër të aktiviteteve të Projekteve. Ato mbulohen nga Buxhetet e donatorëve sipas kontratave të lidhura me ta.

### Komiteti Shqiptar i Helsinkit

#### Pasqyra e të ardhurave e shpenzimeve

Për vitin 2010

Monedha: Lekë

*For Internal use  
Sipas standarteve  
ndërkombëtare*

Nr llogarie			2010	2009
	7,668	<b>Të ardhura</b>		
	7661 & 7662 & 7666 & 7667 & 7681	Fonde të donatorëve	<b>28,676,421</b>	41,455,910
		Të tjera burime të ardhurash		
			<b>28,676,421</b>	<b>41,455,910</b>
		<b>Shpenzime</b>		
641 & 644 & 621	1	Personeli	12,620,660	14,541,124
6001-6009 &	2	Kosto direkte të aktiviteteve	11,861,202	20,846,699

6270,619					
606	3	Fotokopje e materiale zyre	90,725	224,844	
604 & 613 & 614 &					
615	4	Qera e shërbime nga të tretë	1,586,793	1,576,715	
626 & 6260 & 6261					
& 6262 & 6263 &					
& 6264	5	Telekomunikacioni	699,617	1,601,284	
627	6	Transporti	108,814	39,214	
629	7	Përkthime	150,810	61,147	
630	8	Audit/Vlerësim i jashtëm financiar	709,121	1,360,023	
633,638	9	Shërbime ligjore dhe taksa	66,120	12,500	
628	10	Komisione bankare	59,045	99,429	
6811	11	Amortizim	394,854	328,679	
618 & 624	12	Të ndryshme	328,661	764,254	
			<b>28,676,421</b>	<b>41,455,910</b>	
		<b>Rezultati vjetor</b>		<b>0</b>	<b>0</b>

Shpenzimet në kuadër të projekteve janë mbuluar me donacione. Pasqyrat financiare sipas standarteve ndërkombëtare të veprimtarisë të KSHH së për vitin 2010, por edhe për shumicën e Projekteve, janë Audituar dhe çertifikuuar si “brënda standarteve e me tregues të kënaqshëm”. Bilancet dhe pasqyrat financiare të përgatitura sipas Standarteve kombëtare janë dërguar pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë.

# **Lidhja 1**

## **Deklarata dhe njoftime publike gjatë vitit 2010**

<b>17 Mars 2010</b>	<b>Para ligjit të gjithë të barabartë</b>
<b>17 Mars 2010</b>	<b>Shoqëria Civile në Shqipëri mirëpret hyrjen në fuqi të Ligjit kundër Diskriminimit</b>
<b>21 Prill 2010</b>	<b>Veprim antiligjor dhe jo human</b>
<b>11 Maj 2010</b>	<b>Situata është e rëndë, por jo pa rrugëzgjdhje</b>
<b>14 Maj 2010</b>	<b>Për dialogun e shpejtë dhe konstruktiv kërkohet vullnet politik</b>
<b>25 maj 2010</b>	<b>Komedi e drejtësisë: Lirimi "ne fshehtësi" i policit akuzuar për vrasjen e emigrantit shqiptar!</b>
<b>28 Maj 2010</b>	<b>Një akt brutal që duhet ndëshkuar</b>
<b>23 Qershor 2010</b>	<b>Një vendim i diskutueshëm dhe shqetësues</b>
<b>18 gusht 2010</b>	<b>Të lënë të qetë organet e drejtësisë</b>
<b>24 Shtator 2010</b>	<b>Përparësi shëndetit të njerëzve</b>
<b>10 Tetor 2010</b>	<b>Perkthim i deklaratës së Monitoruesit Grek të Helsinkit "Greqia: Ndëshkime ndërkombëtare (gjysmë)-gjyqësore për torturën, keqtrajtimin dhe dëbimin e romëve</b>
<b>18 Tetor 2010</b>	<b>Të parandalohet e "Keqja" dhe organet shtetërore të prononcohen</b>
<b>21 Tetor 2010</b>	<b>Njoftim për Shtyp lidhur me refuzimin e ftesës së PD-së për pjesëmarrje të KShH-së në tryezën politike për ndryshimet në kuadrin zgjedhor</b>
<b>19 Nëntor 2010</b>	<b>Deklaratë e përbashkët për shtyp për parandalimin e importimit të plehrave në Shqipëri (së bashku me disa OJF të tjera)</b>

## Lidhja 2

### Lista e publikimeve të KShH-së gjatë vitit 2010

1. Fletëpalosja ‘Të gjithë të barabartë para ligjit’<sup>6</sup>
2. Manuali ‘Te kuptojmë dhe zbatojmë më mirë ligjin 'Për mbrojtjen nga diskriminimi’’<sup>7</sup>
3. Raport për gjendjen e të drejtave të njeriut në drejtoritë dhe komisariatet e policisë, në institucionet e paraburgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale<sup>8</sup>
4. Kalendarë Sensibilizues<sup>9</sup>

---

<sup>6</sup> Ky publikim është realizuar në kuadër të projektit ‘Rritja e ndërgjegjesimit publik për ligjin e ri për mos diskriminimin’, financuar nga Civil Rights Defenders

<sup>7</sup> Ky publikim është realizuar në kuadër të projektit ‘Rritja e ndërgjegjesimit publik për ligjin e ri për mos diskriminimin’, financuar nga Civil Rights Defenders

<sup>8</sup> Ky publikim është realizuar në kuadër të projektit ‘Së bashku për trajtimin me respekt të të drejtave të njeriut të personave të dënuar me heqje lirie’, financuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian

<sup>9</sup> Kalendarët u publikuan në kuadër të projektit ‘Përmirësimi i të drejtave të njeriut në Shqipëri përmes fuqizimit të shtetit të së drejtës – Klinika Ligjore IV’

### Lidhja 3

#### LISTA E PROJEKTEVE TË ZBATUARA - 2010

<b>Titulli i Projektit</b>	<b>Donatori</b>	<b>Periudha e Zbatimit</b>
<b>PËRMIRËSIMI I SITUATËS SË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË SHQIPËRI PËRMES FUQIZIMIT TË SHKETIT LIGJOR(Klinika Ligjore IV)</b>	<b>Civil Rights Defenders</b>	<b>Mars – Shkurt 2011</b>
<b>SË BASHKU PËR NJË RESPEKTIM MË TË MIRË TË TË DREJTAVE TË PERSONAVE TË PRIVUAR NGA LIRIA</b>	<b>Delegacioni i Komisionit Evropian</b>	<b>Nëntor 2009 - Tetor 2010</b>
<b>RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT PUBLIK PËR LIGJIN E RI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI</b>	<b>Civil Rights Defenders</b>	<b>Janar - Qershor 2010</b>
<b>PËRMIRËSIMI I ZBATIMIT TË LIGJIT TË RI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI</b>	<b>Civil Rights Defenders</b>	<b>Tetor - Dhjetor 2010</b>
<b>RRITJA E KAPACITETEVE TË OJF-VE PËR IDENTIFIKIMIN DHE PËRFAQËSIMIN E RASTEVE TË DISKRIMINIMIT</b>	<b>Civil Rights Defenders</b>	<b>Tetor – Mars 2011</b>
<b>RRITJA E MUNDËSIVE PËR ZBATIMIN E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË SHQIPËRI DHE PËRDORIMI I TYRE PËR REALIZIMIN E TË DREJTAVE TË SHKETASVE</b>	<b>Fondacioni Soros dhe Civil Rights Defenders</b>	<b>1 Nëntor 2010 – Qershor 2011</b>
<b>NGRITJA E KAPACITETEVE PROFESIONALE TË INSTITUCIONIT TË RI-INTEGRIMIT NË KAVAJË</b>	<b>UNICEF Albania</b>	<b>Korrik - Dhjetor 2010</b>
<b>PËR NJË PERSONEL TË BURGJEVE SA MË PROFESIONAL DHE NJË DREJTIM CIVIL TË SISTEMIT SHQIPTAR TË BURGJEVE</b>	<b>Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shqipëri</b>	<b>Korrik 2010 - Korrik 2011</b>

## Lidhja 4

# Statistika rreth shërbimit ligjor të ofruar

### ANKESAT SIPAS KATEGORIVE DHE NENKATEGORIVE (Janar - Dhjetor 2010)

Kategoria	Nenkategoria	Numri i ankesave
<b>Burg/Paraburgim</b>	Cënim I korrespondencës( përgjime të telefonit/hapje e letrave/takimet me familjaret)	1
	Dhunë ( Fizike apo psikologjike) e ushtruar në burg nga personeli /të dënuar të tjerë	8
	Kushte te keqija ne burgje dhe vendet e paraburgimit	5
	Mosdhënie e shërbimit shëndetësor dhe kujdesi social ne burg	12
	Mungesë informacioni nga administrata e brugjeve për amnistinë /faljen	3
	Puna e te burgosurve	44
	Shkelja e të drejtave në paraburgim /burgje	48
	Të tjera	49
	Transferim/mostransferim në një institucion tjetër/brenda të njëjtit institucion	27
<b>Civile të ndryshme</b>	Ankesa në lidhje me konfliktet e pronësisë	15
	Ankesa për shklejen e të drejtës së informimit	1
	Ankesa që lidhen me dhunën në familje/zgjidhjen e martesës/regjistrimin e fëmijëve	5
	Ankesë për procedurat jo transparente nga organet e administrates qendrore dhe vendore	18
	Të tjera	12
<b>Gjyqësori</b>	Ankesë për mospërfitim nga ulja e dënimit/lirim me kusht	4
	Mungesë e dhënies së informacionit nga Gjykatat	3
	Proces i parregullt ligjor	26
	Shkelje procedurale gjatë gjykimit	2

	Tejkalimi I afateve per paraburgimin	2
	Vendime të padrejta gjyqësore/pretendim për pafajësi	22
	Zvarritje e procesit gjyqësor	4
<b><i>Marrëdhëniet e punës</i></b>	Ankesë lidhur me diskriminimin në punë	1
	Ankesë për lëvizje të padrejtë nga puna	6
<b><i>Policia</i></b>	Ankesa për ushtrim dhunë fizike/psikike nga organet e policisë	3
	Te tjera	2
	Veprime të padrejta nga organet e policisë	8
<b><i>Prokuroria</i></b>	Veprime të padrejta dhe arbitrare nga Prokuroria	19
<b><i>Shërbimi Avokator</i></b>	Ankesa për shërbimin avokator kryesisht/të zgjedhur	1
	Asistence ne plotesimin e doc per dergimin e rasteve ne GJEDNJ	1
	Asistencë për plotësim dokumentacioni	9
	Kërkesa për dërgimin e çështjeve në Strasburg	4
	Kërkesa për shërbim avokator falas (perfaqesim ne gjykate)	23
	Këshillim ligjor falas	30
<b><i>Të tjera (sistemi i drejtësisë)</i></b>	Ankesa për mosëkzekutimin e vendimit gjyqësor nga Zyra e Përmbartimit	5
	Kërkesa për ekstradim	1
<b>Totali i ankesave te marra</b>		<b>424</b>

ANKESAT SIPAS TË DREJTAVE TË SHKELURA (Janar - Dhjetor 2011)

<b>E DREJTA</b>	<b>Numri i ankesave</b>
<b>E drejta e informimit</b>	<b>13</b>
<b>E drejta për ankimim efektiv</b>	<b>1</b>
<b>E drejta për te mos u diskriminuar dhe barazia e shtetasve</b>	<b>5</b>
<b>Ndalimi i Torturës</b>	<b>50</b>
<b>E drejta për liri dhe siguri</b>	<b>11</b>
<b>E drejta për një proces të rregullt ligjor</b>	<b>74</b>
<b>E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare</b>	<b>4</b>
<b>E drejta e pronësisë</b>	<b>15</b>
<b>Te tjera</b>	<b>251</b>
<b>Total</b>	<b>424</b>

Shërbimet Ligjore të Ofruara për Ankesat e marra (Janar - Dhjetor 2011)

<b>SHERBIMI I OFRUAR</b>	<b>NUMRI I SHERBIMEVE</b>
<b>Asistente per plotesim doc</b>	<b>5</b>
<b>Keshillim Ligjor</b>	<b>256</b>
<b>Monitorim Procesi Gjyqesor</b>	<b>27</b>
<b>Nderhyrje Ins.shteterore</b>	<b>397</b>
<b>Perfaqesim ne Gjykate</b>	<b>15</b>



<b>Reagime publike</b>	6
<b>Trajtim ankese</b>	519
<b>Verifikim</b>	210
<b>Total</b>	<b>1,435</b>